





Problema me 3 pikë

1. Në cilin diagram pjesa e hijëzuar ka sipërfaqen më të madhe?









(E) Të gjitha pjesët e hijezuara kanë të njëjtën sipërfaqe

2. Viti 2026 quhet "i gjithë çift" sepse 2026 përbëhet vetëm nga shifra çift. Sa vite do të kalojnë para se të vijë viti tjetër "i gjithë çift", ku shifrat e tij janë të gjitha të ndryshme?

(A) 2 (B) 20 (C) 22 (D) 38 (E) 42

3. Kangurja Karla po shikon grumbullin me njëzet kuti, siç tregohet. çfarë do të shohë ajo?



4. Nga qyteti A në qytetin B ka tre rrugë të ndryshme. Nga qyteti B në qytetin C ka pesë rrugë të ndryshme. Ahmedi udhëton nga qyteti A në qytetin C, nëpërmjet qytetit B. Ai dëshiron të kthehet në qytetin A nëpërmjet qytetit B me një rrugë që nuk është plotësisht e njëjtë me rrugën që përdori nga A në C. Sa rrugë të mundshme mund të zgjedhë ai për udhëtimin e kthimit?

(A) 5 (B) 6 (C) 10 (D) 12 (E) 14







5. Matini vendosi një orë dixhitale para një pasqyre dhe vuri re se numrat në pasqyrimin e orës në pasqyrë tregonin një kohë të ndryshme të ditës. Cilën nga kohët e mëposhtme tregonte ora e Matinit?



6. Xhohi dëshironte ti vendoste numrat 2, 0, 2 dhe 6 në kutitë e treguara $\frac{\square + \square}{\square - \square}$ me nga një numër në secilën kuti dhe të llogariste rezultatin. Cili është rezultati më i vogël **pozitiv** që ajo mund të marrë?

- (A) $\frac{1}{6}$ (B) $\frac{1}{4}$ (C) $\frac{1}{3}$ (D) $\frac{1}{2}$ (E) $\frac{2}{3}$

7. Enigma në të djathtë mund të plotësohet me cilëndo nga pesë pjesët e mëposhtme.
Me cilën pjesë mund të shihni më shumë ishuj në enigmën e plotësuar?









8. Cili nga numrat e mëposhtëm **nuk është** shuma e dy ose më shumë numrave të plotë pozitivë të njëpasnjëshëm?

- (A) 5 (B) 6 (C) 7 (D) 8 (E) 9

9. Ada ka përdorur një shabllon letre për të bërë figurën e treguar. Vijat e ndërprera në shabllon tregojnë se ku do ta paloste ajo dhe vijat e plota tregojnë se ku do ta priste.

Cilin shabllon përdori Ada?



10. Katër vende në një rresht, me numrat 1-4, të numëruara nga e majta në të djathtë janë të zëna nga Andi, Beni, Urtina dhe Diana, jo në këtë renditje, por me kushtet e mëposhtme:


- Andi nuk është në vendin 1.
- Beni është direkt në të djathtë të Andit.
- Diana nuk është në asnjërin skaj.
- Urtina nuk është në vendin 3.

Në çfarë radhe, nga e majta në të djathtë, ulen ata?

- (A) Beni, Diana, Andi, Urtina (B) Citra, Andi, Diana, Beni (C) Urtina, Diana, Andi, Beni
(D) Urtina, Diana, Beni, Andi (E) Diana, Urtina, Beni, Andi


Problema me 4 pikë

11. Një hartë e një pjese të qytetit Kangaroo është treguar në diagramë, ku zonat e bardha paraqesin rrugët. Rregullat e qytetit Kangaroo specifikojnë se në çdo kryqëzim, automjetet mund të ecin vetëm drejt ose të kthehen djathtas. Ana dëshiron të udhëtojë nga pika A në pikën B përgjatë rrugëve të treguara. Sa është numri më i vogël i herëve që ajo duhet të kthehet djathtas?



- (A) 4 (B) 5
(C) 6 (D) 7
(E) 9

12. Filxhani im ka shifrat nga 1 deri në 9. Mund të shihet në katër nga fotografitë e mëposhtme. Cila fotografi tregon një filxhan të ndryshëm nga ajo?




13. Mariam ka 130 lekë më pak se shuma totale që kanë Ria dhe Emma. Ria ka 50 lekë më shumë se shuma totale që kanë Emma dhe Mariam. Sa lekë ka Emma?

- (A) 180 (B) 170 (C) 80 (D) 70 (E) 40

14. Në një pyll magjik jetojnë pesë elfë të vegjël dhe një elf i vjetër. Çdo elf i vogël ha gjashtë qershi në ditë. Çdo ditë, elfi i vjetër ha pesë qershi më shumë sesa numri mesatar i qershivë të ngrëna nga të gjashtë elfët. Sa qershi ha elfi i vjetër çdo ditë?


- (A) 10 (B) 11 (C) 12 (D) 13 (E) 14

15. Miu Mirko ka tre blloqe djathi me madhësi të ndryshme, secili i përbërë nga kube me madhësi identike, siç tregohet në diagramin e parë. Ai hëngri 40 % të bllokut të parë të djathit, 40 % të të dytit dhe 20 % të të tretit. Çfarë përqindjeje të sasisë totale të djathit hëngri Mirko?



- (A) 18 %
- (B) 20 %
- (C) 23 %
- (D) 24 %
- (E) 25 %

16. Sa është shuma e të gjitha këndeve të hijëzuara?



- (A) 180°
- (B) 240°
- (C) 270°
- (D) 360°
- (E) 450°





17. Në klasën time ka më shumë se 23 dhe më pak se 29 nxënës. Të gjithë pëlqejnë të paktën njëren nga lëndët, matematikën ose frëngjishten. Matematikën e pëlqejnë dyfish më shumë nxënës se sa pëlqejnë frëngjishten. Numri i nxënësve që pëlqejnë edhe matematikën edhe frëngjishten është i njëjtë me atë që pëlqejnë vetëm frëngjishten. Cili nga këta numra është numri i përgjithshëm i nënësve në klasën time?

- (A) 24
- (B) 25
- (C) 26
- (D) 27
- (E) 28

18. Shifra e njësive të një numri është 1. Julio e heq këtë shifër për të marrë një numër të ri që është 2026 më i vogël se numri origjinal. Cila është shuma e shifrave të numrit origjinal?

- (A) 10
- (B) 12
- (C) 14
- (D) 16
- (E) 18

19. Figura në të djathtë tregon një shabllon nga i cili mund të bëhet një kub. Cila nga pamjet e mëposhtme tregon kubin e përfunduar?




20. Në problemin e mbledhjes së dhënë, çdo shkronjë e përdorur përfaqëson një shifër të vetme, dhe shkronja të ndryshme përfaqësojnë shifra të ndryshme. Cila është vlera e $A + B + C$?

$$\begin{array}{r} A B C \\ + A C B \\ \hline C 4 A \end{array}$$

- (A) 16 (B) 17 (C) 18
(D) 19 (E) 20

Problema me 5 pikë

21. Një formë është bërë nga pesë katrorë që prekin njëri-tjetrin me sipërfaqe 1 m^2 , 4 m^2 , 9 m^2 , 16 m^2 dhe 25 m^2 në një rend të caktuar, bazat e të cilave shtrihen të gjitha në një vijë të përbashkët. Pika A është një kulm i katrorit të majtë. Valmiri e pret formën përgjatë vijës AB , e cila është paralele me CD . Cila është sipërfaqja e formës së mbetur, siç tregohet?



- (A) 44.5 m^2 (B) 45.5 m^2 (C) 46.5 m^2
(D) 47.5 m^2 (E) 48.5 m^2

22. Unë kam dy orë të vjetra, orën e gjyshit tim dhe orën e babait tim. Ora e gjyshit tim humbet 5 minuta çdo orë, dhe ora e babait tim shton 5 minuta çdo orë. Dje i vendosa në kohën e saktë në orën 21:00. Kur u zgjova të nesërmen në mëngjes, ora e gjyshit tim tregonte 08:00. Cila është koha që tregonte ora e babait tim në atë moment?

- (A) 9:00 AM (B) 9:30 AM (C) 10:00 AM (D) 10:30 AM (E) 11:00 AM

23. Drejtkëndëshi i paraqitur është i ndarë në gjashtë pjesë drejtkëndëshe. Janë dhënë sipërfaqet e pesë prej pjesëve. Cila është sipërfaqja e pjesës së gjashtë?


24	42	
	9	?
12	18	

- (A) 14 (B) 15
(C) 16 (D) 18
(E) 20

24. Ana, Blerta dhe Sara shkuan në një dyqan kancelarie për të blerë stilolapsa dhe vizore. Secila prej tyre bleu saktësisht 10 artikuj gjithsej. Ana bleu dy herë më shumë stilolapsa sesa Sara bleu vizore. Blerta bleu dy herë më shumë stilolapsa sesa Ana bleu vizore. Gjithsej, vajzat blenë një numër çift vizorësh. Sa stilolapsa bleu Blerta?

- (A) 2 (B) 4 (C) 6 (D) 7 (E) 8

25. Trekëndëshi $A'BC'$ fitohet duke rrotulluar trekëndëshin ABC rreth kulmit B . Pikat C , A' dhe C' shtrihen në një vijë të drejtë, ashtu si edhe pikat A , B dhe C' . Madhësia e këndit BCA është 15° . Cila është madhësia e këndit BAC ?



- (A) 105° (B) 115° (C) 120° (D) 135° (E) 140°

26. Një kub i madh me gjatësi brinje 4 njësi, përbëhet nga kube të vogla me gjatësi brinje 1 njësi. Cili është numri më i vogël i kubeve me brinjë 1 njësi që duhet të hiqen nga kubi i madh për të rritur sipërfaqen e formës me 50%?

- (A) 6 (B) 8 (C) 10 (D) 12 (E) 18

27. Sa nga katër pohimet më poshtë janë të vërteta?

- (1) Saktësisht dy nga pohimet janë të gabuara.
- (2) Ky pohim është i vërtetë.
- (3) Pohimi i mëparshëm është i vërtetë.
- (4) Tre pohimet e mësipërme janë të gabuara.


- (A) 0 (B) 1 (C) 2 (D) 3 (E) 4

28. Diamanta dëshiron t'i vendosë pesë numrat 1, 2, 3, 4 dhe 5 në një radhë në mënyrë të tillë që numri i fundit të jetë tek dhe shuma e çdo tre numrave të njëpasnjëshëm të jetë e pjesëtueshme me numrin e parë të treshes. Sa radhitje të tilla mund të bëjë ajo?

- (A) 2 (B) 3 (C) 4 (D) 5 (E) 6

29. Bernardi dëshiron të vizatojë një pesëkëndësh $ABCDE$ me diagonale AD , në të cilën $EA = ED$ dhe $AB = CD$. Ai dëshiron që AD të jetë paralel me BC . Fatkeqësisht, vizatimi i tij nuk është shumë i saktë.

Gjithashtu, ai dëshiron që këndi $\angle AED$ dhe këndi $\angle ADC$ të jenë të barabartë, dhe që raporti i madhësive të këndit $\angle EDA$ dhe këndit $\angle BAD$ të jetë $3 : 2$. Në një diagram të saktë, cila do të ishte madhësia e këndit $\angle DCB$?



- (A) 135° (B) 125° (C) 120° (D) 115° (E) 110°

30. Ana, Elsa dhe nëna e tyre po luajnë një lojë arsyetimi. Nëna e tyre zgjedh një ëmbëlsirë nga opsionet e treguara më poshtë. Ajo i tregon Anës modelin e mbështjellësës dhe i tregon Elës formën e ëmbëlsirës. Nëna së pari pyet: A e di cilën ëmbëlsirë zgjodha? Si Ana ashtu edhe Elsa përgjigjen Jo. Nëna pyet për herë të dytë: Tani e di? Përsëri të dyja përgjigjen Jo. Megjithatë, kur nëna pyet për herë të tretë, si Ana ashtu edhe Elsa përgjigjen saktë në të njëjtën kohë. Cila ëmbëlsirë u zgjodh?

